



Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivery	19.12.2023	3	viti god veç
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Pulog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTHC	7460/2023		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1405/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, si dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1405/2023 të datës 13.11.2023 të parashtruar nga ankuesja

kundër organit të punësimit/Komuna e Istogut, në çështjen juridike "Kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 14.12.2023,mori këtë:

V E N D I M

I. Detyrohet Komisioni i Pranimit i themeluar sipas Vendimit me Nr. 01-893/023 të datës 02.10.2023 për grupin Specialist të Punës Sociale për pozitën "Zyrtar për Mirëqenie Sociale 1", në Komunën e Istogut, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të nxjerr aktin administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi lidhur me shqyrtimin e ankesës së datës 01.11.2023 të parashtruar nga ankuesja

II. Obligohet Kryetari i Komunës së Istogut, që të kujdeset që ky vendim të zbatohet si në pikën I

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Komuna e Istogut më datë 23.08.2023 ka publikuar konkursin me Nr. Reference: RN00012384 për grupin Specialist të Punës Sociale për pozitën "Zyrtar për Mirëqenie Sociale 1", ku afati për aplikim

ka qenë nga data 13.09.2023 deri më datë 27.09.2023. Në këtë konkurs kanë aplikuar dhjetë (10) kandidatë në mesin e tyre edhe ankuesja, ndërsa pas verifikimit paraprak sipas njoftimit të datës 03.10.2023 ka rezultuar se në listën e ngushtë janë përfshirë shtatë (7) kandidatë në mesin e tyre edhe ankuesja, e cila i është nënshtruar fazave të procedurës (testit me shkrim, vlerësimit të jetëshkrimit dhe intervistës me gojë).

Pas përfundimit të procedurës, më datë 31.10.2023 është publikuar njoftimi për rezultatin përfundimtar, me kandidatin fituese G.A-O me 94.6 pikë, ndërsa sipas renditjes përfundimtare të kandidatëve ankuesja ka marr gjithsej 69.6 pikë. Sipas njoftimit të datës 31.10.2023 kandidatëve në procedurë të pakënaqur me rezultatin përfundimtar i është dhënë këshilla juridike për ankesë në afat prej 3 ditësh në Komisionin e Pranimit.

Ankuesja më datë 01.11.2023 ka parashtruar ankesë, ndërsa Udhëheqësi i Personelit i Komunës së Istogut më datë 03.11.2023 ka njoftuar ankuesen se bazuar në Ligjin Nr. 08/1-197 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil ankesën mund ta adresoni në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës brenda 30 ditëve.

Ankuesja më datë 13.11.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 6964/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 20.11.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Istogut. Ndërsa kjo fundit më datë 24.11.2023, ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat lidhur me çështjen në shqyrtim.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ,me rastin e shqyrtimit të kësaj ankesë ka administruar këto prova:Ankesën me numër protokolli 6964/2023 të datës 13.11.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin e datës 31.10.2023; Ankesën e datës 01.11.2023 e parashtruar nga ankuesja; Pasqyrën nga SIMBNJ; Konkursin me Nr. Reference: RN00012384 për grupin Specialit të Punës Sociale për pozitën "Zyrtar për Mirëqenie Sociale 1"; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 20.11.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 24.11.2023; Njoftimin e datës 03.11.2023; Rënditjen përfundimtare të kandidatëve; Vendimin me Nr. 01-893/023 të datës 02.10.2023 për themelimin e Komisionit të Pranimit; Njoftimin e datës 03.10.2023 dhe 29.09.2023; Listën e aplikantëve; Kontratë për praktikë e datës 07.02.2017 për kandidatin G.A, Dokument identifikimi, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 25.09.2023, Certifikatën nga Kolegji AAB, Diplomën me Nr. 1784/17; Diplomën e datës 17.03.2023 të ankueses, Certifikatën shtator 2023, mars 2023, 27 maj 2022, prill 2022, tetor 2021, gusht 2018, Akt Emërimit e datës 08.08.2016, Vendimin e datës 18.11.2016, Akt Emërimit e datës 20.10.2017, Dokument identifikimi, Formularin për vlerësimin e rezultateve në punës i datës 31.01.2023 dhe vitit 2021, Vërtetimin e datës 18.09.2023.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave (në tekstin në vijim Kolegji i Këshillit), pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës, ka konstatuar se meqenëse nuk është nxjerr akt administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi, atëherë ekziston baza ligjore që të detyrohet Komisioni i Pranimit i themeluar sipas Vendimit me Nr. 01-893/023 të datës 02.10.2023, që të bëjë shqyrtimin e ankesës të datës 01.11.2023 të parashtruar nga ankuesja dhe të nxjerr akt administrativ, *sepse*:

Lidhur me këtë çështje juridike-administrative, Kolegji i Këshillit, në bazë të provave materiale të lëndës, konstaton se sipas njoftimit të datës 31.10.2023 kandidatëve në procedurë të pakënaqur me rezultatin përfundimtar i është dhënë këshilla juridike për ankesë në afat prej 3 ditësh në Komisionin e Pranimit, ndërsa ankuesja më datë 01.11.2023 ka parashtruar ankesë, ndërsa Udhëheqësi i Personelit i Komunës së Istogut më datë 03.11.2023 ka njoftuar ankuesen se bazuar në Ligjin Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil ankesën mund ta adresoni në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, brenda 30 ditëve.

Nga shqyrtimi i njoftimit të datës 03.11.2023 të Udhëheqësit të Personelit të Komunës së Istogut lidhur me ankesën e ankueses së datës 01.11.2023, udhëzohet ankuesja se ankesën meqenëse ka hy në fuqi Ligji Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullorja (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil ankesën mund ta adresoni në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, brenda 30 ditëve, Kolegji i Këshillit, lidhur me këtë konstaton se Ligji Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë është publikuar në Gazetë Zyrtare të Republikës së Kosovës më datë 18.09.2023 ndërsa ligj hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës siç parashihet me nenin 105 të këtij ligji, ndërsa sipas nenit 99 paragrafi 6 dhe 7 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, është përcaktuar se: "6. Procedurat e rekrutimit, të disiplinës apo të ankesave të filluara dhe të papërfunduara në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë sipas dispozitave të mëparshme ligjore, që kanë rregulluar çështjet përkatëse. 7. Hyrja në fuqi e këtij ligji përbën shkas për përfundimin e mandatit të komisioneve të themeluara në bazë të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik. Në rast se këto komisione kanë në shqyrtim procedura të rekrutimit, të disiplinës apo të ankesave, duhet të përfundojnë këto procedura, dhe më pas konsiderohet se përfundon mandati i tyre" , rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, marr parasysh që procedura e pranimit sipas konkursit me Nr. Reference: RN00012384 për grupin Specialit të Punës Sociale për pozitën " Zyrtar për Mirëqenie Sociale 1", ka filluar para se të hyjë në fuqi ky ligj, atëherë konstaton se është obligim ligjor që edhe procesi i shqyrtimit të ankesës së ankueses të përfundojë sipas dispozitave që ka nisur procedura konkretisht sipas Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe dispozitat e nenit 25 paragrafi 6 ndërlidhur me nenin 31 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës, ngase procedurat e filluara sipas Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës nuk mund të shqyrtohen sipas Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë.



Kolegji i Këshillit ndërlidhur me bazën ligjore të potencuar si më lartë, konstaton faktin se Komisioni i Pranimit i themeluar sipas Vendimit me Nr.01-893/023 të datës 02.10.2023 për grupin Specialist të Punës Sociale për pozitën "Zyrtar për Mirëqenie Sociale 1", në Komunën e Istogut është i obliguar që në pajtim me Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, Ligjin e aplikuar në këtë periudhë Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dispozitat e nenit 25 paragrafi 6 ndërlidhur me nenin 31 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës të shqyrtoj ankesën e datës 01.11.2023 të parashtruar nga ankuesja me të gjitha pretendimet e saj si në ankesë, duke nxjerr akt administrativ në pajtim me nenin 47 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative dhe të njëjtin ta arsyetoj sipas dispozitave të nenin 48 ndërlidhur me nenin 134 paragrafi 1 të këtij ligji.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.1405/2023, datë 14/12/2023

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Istogut;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Istogut dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

